



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

KËSHILLI I QARKUT LEZHË

V E N D I M

Nr. 54, datë 04.12.2015

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT NË QARKUN E LEZHËS”

Bazuar në ligjin 8652 dt 30.07. 2000, “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, i ndryshuar, Ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e KM nr. 861 , datë 10.12.2014, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, dhe me propozim të Komisionit Këshillimor për Dhënie të Titujve të Nderit , pas diskutimit të anëtarëve, Këshilli i Qarkut Lezhë

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores për dhënie të titujve të nderit në Qarkun e Lezhës, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 22 datë 08.05.2008 “Për miratimin e rregullores së komisionit të vlerësimit të figurave për dhënie tituj nderi”.
3. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor dhe Sektori Juridik në Këshillin e Qarkut.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI

Esmeralda NDOKA

KRYETARI

Gjok NDOKA



Nr. 1763 Prot

Date 4/12/2015



RREGULLORE PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT NË QARKUN E LEZHËS

U hartua në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të KM nr. 861, datë 10.12.2014, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"

Hyrje Neni 1

Tituj nderi u jepen individëve vendas a të huaj si dhe personave fizikë e juridikë për kontribute të veçanta me ndikim të dallueshëm në zhvillimin historik, social - ekonomik, kulturor e sportiv të Qarkut të Lezhës.

Neni 2 Titujt e Nderit

Këshilli i Qarkut Lezhë jep këta tituj nderi:

- Nderi i Qarkut Lezhë
- Mirënjohja e Qarkut Lezhë
- Mik i Qarkut Lezhë

Neni 3 Përshkrimi i titujve

NDERI I QARKUT LEZHË. Me këtë titull të nderohen individë (edhe pas vdekjes) apo institucione veprimtaria e të cilëve ka pasur ose ka ndikim shumë pozitiv në zhvillimin historik, shkencor, kulturor, social e sportiv në Qarkun e Lezhës.

MIRËNJOHJA E QARKUT LEZHË. T'u japet individëve, organizmave e institucioneve që kanë dhënë ose japin ndihmesa të veçanta në fusha të ndryshme të zhvillimit social ekonomik të Qarkut të Lezhës.

MIK I QARKUT LEZHË. T'u jepet individëve të huaj e vendas (jashtë Qarkut Lezhë), që kanë shpalosur frymë miqësore dhe kanë promovuar vlerat e mikpritjes e traditës në Qarkun e Lezhës



Neni 4

E drejta e propozimit për titull nderi

Të drejtën për të propozuar për dhënie titull nderi e kanë:

1. Institucionet lokale, rajonale e nacionale, ku ka ushtruar ose ushtron veprimtarinë përsoni i propozuar për titull nderi
2. Këshillat e bashkive dhe anëtarët e Këshillit të Qarkut Lezhë
3. Shoqatat joqeveritare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rajon

Neni 5

Kriteret për propozim

1. Propozimi për titull nderi bëhet duke pasur parasysh, meritat të veçanta të individit, përsonit fizik a juridik, rolin dhe ndikimin e tyre për zhvillimin social-ekonomik të Qarkut Lezhë.
2. Propozimi të jetë pranuar nga institucioni në rrugë protokollare dy muaj para Mbledhjes së Këshillit të Qarkut.
3. Propozimi duhet të jetë i nënshkruar nga titullarët e institucionit që bëjnë propozimin si dhe nga anëtarët e Këshillit që bëjnë propozime për dhënie titulli, i cili duhet të shoqërohet me një profil të shkurtër të përsonit të propozuar, ku të shpalosen arritjet dhe cilësitë e veçanta të tij
4. Dokumentacioni i plotë i identitetit të përsonit të propozuar
5. Nuk mund të propozohet dy herë për të njëjtin titull
6. Motivacioni për dhënie titulli

Neni 6

Komisioni Këshillimor

Komisioni Këshillimor për Dhënie Tituj Nderi në Qarkun e Lezhës është një organ kolegjal, vendimmarrës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë, i ngritur me urdhër të titullarit bazuar në VKM 861, datë 10.12.2014 dhe përbehet nga pesë anëtarë, prej të cilëve, tre janë punonjës në varësi të Institucionit dhe dy anëtarë të jashtëm, personalitete të shquara në fusha të ndryshme.



Neni 7

Funksionimi i Komisionit Këshillimor

1. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicë votash, kryetarin dhe sekretarin e tij dhe vendos për titujt e nderit që do të jap Këshilli i Qarkut Lezhë dhe i paraqet ati relacionin përkatës, i cili firmoset nga kryetari dhe sekretari komisionit
2. Komisioni harton rregulloren e funksionimit të tij dhe ja paraqet për miratim Këshillit të Qarkut
3. Kryetari drejton mbledhjen, drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
4. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas paraqitjes së kërkesës dhe, të paktën, 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.
5. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.
6. Mbledhja është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara më sipër, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
7. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

Neni 8

Vendimmarrja dhe mënyra e votimit

1. Të gjitha propozimet për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit i dërgohen autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell për vlerësim në komisionin këshillimor.
2. Komisioni shpreh mendimin e vet edhe nëse nisma për dhënien e medaljeve ose titujve vendorë të nderit është ndërmarrë nga autoriteti përgjegjës për dhënien e tyre.
3. Komisioni nis punën me verifikimin e të gjitha elementeve, të kërkuara nga neni 18, i ligjit nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", të aktit të propozimit.
4. Nëse propozimi nuk është i plotë, komisioni këshillimor kërkon, me shkrim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së propozimit,



- plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
5. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e vet pranë autoritetit përgjegjës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit.
 6. Komisioni, gjatë organizimit të punës, respekton afatet e përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë". Në çdo rast, procedurat për shqyrtimin e dhënies së një medaljeje ose titulli nderi nuk mund të zgjatën më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike.
 7. Komisioni shqyrton propozimet dhe merr vendimin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.
 8. Anëtarët e komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.
 9. Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.
 10. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen, vendimet e marra, si dhe mënyra dhe rezultati i votimeve.
 11. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet, për miratim dhe nënshkrim, të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
 12. Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në scanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të scancës përkatëse.
 13. Anëtarët mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi.
 14. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të medaljes ose titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave. Arsyet e shtyrjes apo të pezullimit, si dhe afati, pasqyrohen në procesverbal.



Neni 9 Refuzimi për dhënie titulli

Kur propozimi për dhënien e medaljes apo titullit vendor të nderit nuk miratohet, komisioni njofton autoritetin propozues për mosmiratimin. Në çdo rast, vendimi i arsyetuar dhe procesverbali i mbledhjes i përcillen autoritetit përgjegjës.

Neni 10 Ceremonia e dhënie së titullit

1. Në rast se propozimi miratohet nga autoriteti përgjegjës, urdhri ose vendimi i dërgohet komisionit për përgatitjen e medaljeve, rathëve të argjendtë dhe certifikatave përkatëse, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit.
2. Komisioni ndjek procedurën e përgatitjes së medaljeve, rathëve të argjendtë dhe certifikatave përkatëse. Pas përgatitjes së tyre, komisioni njofton autoritetin propozues për organizimin e ceremonisë për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit si dhe për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.
3. Dhënia e titullit të bëhet brenda 30 ditëve nga data e vendimit të këshillit

Dispozita të fundit Neni 11

Komisioni planifikon në buxhetin e çdo viti shpenzimet për kompozimin dhe prodhimin e titujve ,ceremonive për dhënien e tyre si dhe shpërblimin e Komisionit Këshillimor për Dhenie Titull Nderi në Qarkun e Lezhës dhe ja dorëzon Komisionit të hartimit e detajimit të buxhetit për ta planifikuar si zë të veçantë të tij, për çdo vit

Neni 12

Ngarkohen autoritetet përgjegjëse, të parashikuara në ligjin nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.kryetari dhe sekretari i këshillit,drejtoria e financës,drejtoria juridike dhe Komisioni këshillimor.

Neni 13

Kjo rregullore hyn në fuqi , pas miratimit në Këshillin e Qarkut Lezhë.